ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIMIKIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**205-24-5833-1-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me uniforma verore dhe dimërore Lot 1 dhe Lot 2"
LOT 2:

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Sodex Group SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fehmi Agani Nr.36
(Adresa)

Prishtinë — ***10 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

04414818
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Luan Avdiu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

office@sodex-ks.co
(Adresa elektronike)

03.09.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) — (Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K SODEX GROUP NR. 0755336 PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 11.06.2024 Hapja e ofertave:08.07.2024 Njoftimi mbi vendimin:19.08.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt.26.08.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.29.08.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 37 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ky tender është i ndarë në dy lote, ndërsa ne kemi ofertuar vetëm **në Lot 2**, prandaj edhe ankesa ka të bëjë vetëm për Lot 2.
Njoftimi mbi vendimin është publikuar me dt.19.08.2024 ku është rekomanduar për kontratë për Lot 2 Naim Shuki BI me çmim prej:20,040 €, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe pas qasjes që kemi pasur dhe pas analizës së dokumenteve që i kemi bërë, kemi vërejtur se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm sepse mostra e ofruar nga ky OE nuk ka plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme.
Mostrat të cilat nuk i kanë plotësuar specifikimet teknike nga OE i rekomanduar për kontratë janë të vendosura në tabelën e mëposhtme:

Lot -2, Njësia e Peshoreve

Është kërkuar tek specifikimet teknike-Aneksi 1	OE i rekomanduar për kontratë
Xhaketa e jashtme Duhet të ketë xhepa të kraharorit te padukshëm	Nuk ka ofruar
Xhaketa e brendshme: 100% poliester, 350 gr/m2, pjesa larte mbrapa 100% najlon	Është vetëm nga materiali poliester, prandaj nuk plotësohet specifika e kërkuar
Xhaketa e jashtme është e qepur dhe e ngjitur me tegel plotësisht të vullkanizuar për rezistence ndaj ujit, e qëndrueshme ndaj erës dhe duhet të jete me material që lejon ajrosjen.	Nuk ka tegele te vullkanizuar, xhaketa nuk është rezistente ndaj ujit, prandaj nuk plotësohet specifika e kërkuar.
Sistem me zinxhir të qepur anash për ajrosje të mjaftueshme.	Nuk ka zinxhir anash
STANDARDET E LARTPERMENDURA DUHET TE DOKUMENTOHEN ME RAPORTE TESTUESE NGA LABORATORET ME AKREDITIM NDERKOMBETAR.	Nuk ka ofruar asnjë raport testues për jakne. Nga 2 raporte testuese që ka ofruar asnjeri nuk është për jakne. Njeri është i prodhuesit te materialeve Akrida, me te cilin prodhues nuk ka asnjë mostër, ndërsa testi tjetër është për Epauleta Policore
Tek dy modelet **e pantallonave** është kërkuar: *Zinxhirë origjinal YKK dhe butona Prym*	Nuk ka as zinxhirë e as butona origjinal sipas kërkesës se AK-se.
Këpucët duhet të jenë të papërshkueshme nga uji	**Nuk janë të papërshkueshme nga uji**
Ato duhet të jenë antistatike sipas standardeve CE EN ISO 20347:2012 O2 HRO HI CI WR FO SRC.	Nuk janë antistatike dhe nuk dëshmohen se këpucët janë sipas kësaj kërkese te AK-se
Papërshkueshmëria nga uji	Nuk janë të papërshkueshme nga uji
Qepje të vullkanizuara (salduara)	Nuk janë me Qepje të vullkanizuara (salduara)
Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas EN ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) dhe EN ISO 14001:2015	Nuk ka ofruar asnjë dëshmi për këto certifikime, prandaj është i papërgjegjshëm
Këpucët duhet të prodhohen dhe testohen sipas EN ISO 20347: 2012.	Nuk janë te prodhuara dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se këpucët janë sipas kësaj kërkese të AK-se
	Certifikatat e ofruar nuk përputhen me mostrat e ofruar, si dhe dizajni i ofruar nuk është sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Nga tabela e lartcekur shihet qartë se mostrat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë sipas specifikimeve teknike të detyrueshme, e po ashtu nuk janë ofruar dëshmi për certifikime, certifikimet nuk përputhen me mostrat e këpucëve etj. Pastaj nuk janë përmbushur specifikimet për pantallona, xhaketa të jashtme dhe të brendshme dhe një mori specifikash të cilat u cekën më lartë, prandaj oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme.

Përgjigjen në kërkesë për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.29.08.2024, ku është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, ndërsa arsyetimi është dhënë si më poshtë:

Sa i perket pretendimit ankimore lidhur me OE te rekomanduar per kontrate se i njeti nuk ka permbushur kerkesat e DT dhe FDT-së, nuk qendron ky pretendim pasi qe OE i rekomanduar per kontrate me rastin e dorezimit te ofertes ka permbushe te gjitha kerkesat qe kane te bejne me DT dhe FDT-së .Duke bazuar ne Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "LPP ", indryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligji Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 perkatesit Neni 1 Qellimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4 nenparagrafi (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që,çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

AK pas rishqyrtimit te pretendimeve ankimore ka konstatuar se pretendimet ankimore te Operatori Ekonomik „Sodex Group SH.P.K." refuzohet si e pabazuar .

Realisht kjo përgjigje e AK-së nuk ka të bëjë me arsyetim fare dhe me përgjigje konkrete, por kjo përgjigje është abstrakte dhe jo profesionale, pasi që nuk është dhënë asnjë argument për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.
Më pastaj përmendja e devijimeve të vogla në këtë përgjigje tregon qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme edhe pse vetë autoriteti kontraktues nuk e ka cekur se cilat janë ato devijime të vogla dhe përse quhen devijime të vogla.
Vetë fakti se nuk përmendën se cilat mangësi i ka konsideruar devijime të vogla për OE të rekomanduar për kontratë, tregon që AK-ja në mënyrë implicite e ka pranuar se ky ofertues është i papërgjegjshëm, mirëpo në të njëjtën kohë bënë përpjekje që të mbetet fitues OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht që është i papërgjegjshëm.
Pra edhe me përgjigje në kërkesë për rishqyrtim, autoriteti kontraktues nuk ka mundur në asnjë mënyrë të dëshmojë përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë, e kjo kuptohet qartë kur analizohen mostrat e këtij operatori ekonomik, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që ti shqyrtojë në detaje pretendimet tona ankimore ta konfirmojë papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë dhe ta detyrojë autoritetin kontraktues që ta korrigjojë gabimet dhe lëshimet në lidhje me këtë procedurë të prokurimit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe specifikimet teknike të detyrueshme, ndërsa neve jemi

diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET** e bazuar ankesa e OE "**Sodex Group SH.P.K për Lot 2.**

I. **ANULOHET,** njoftimi mbi vendimin e AK-së B58 **për dhënie të kontratës i datës 22.08.2024** për **Lot 2** dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesë në OSHP në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*